



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

**K.P.P.360/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.07.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK dhe BOE “KMK” SHPK& “Caushi M” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-91657-03-30-2021, me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Bejar – diga e rezervuarit*”, me fond limit 59,394,361.54 (pesëdhjetë e nëntëmilion e treqind e nëntëdhjetë e katërmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa T.V.SH, zhvilluar në datën 30.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.

**Ankimues:** “Shkëlqimi 07” SHPK  
Fashati Belishovë, Ballsh, Fier

**Autoriteti kontraktor:** Bashkia Mallakastër  
Lagjia “18 Prilli”, Ballsh, Mallakastër

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e*

*rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 31.03.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-91657-03-30-2021, me objekt “*Rikonstruktion i*

*rrugës Bejar – diga e rezervuarit*”, me fond limit 59,394,361.54 (pesëdhjetë e nëntëmilion e treqind e nëntëdhjetë e katërmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa T.V.SH, zhvilluar në datën 30.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër..

II.2. Në datën 30.04.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 19.05.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojn si më poshtë vijon:

1. BOE “Ndregjoni” SHPK & “Udha” SHPK	28,061,425	I skualifikuar
2. BOE “KMK” SHPK & “Caushi M” SHPK	34,986,000	I kualifikuar
3. “LTE Construction” SHPK	35,087,500	I skualifikuar
4. “B93 II” SHPK	40,000,570	I skualifikuar
5. Shendelli SHPK	43,858,875	I kualifikuar
6. Shkëlqim 07 SHPK	47,000,000	I kualifikuar
7. “VAS Konstruksion” SHPK	55,554,650	I skualifikuar

II.4. Në datën 24.05.2021 operatori ekonomik “Shkëlqim 07” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

*-Në datën 19.05.2021, ora 15:57 (19 ditë me vonesë nga data e hapjes së ofertave), shoqëria “Shkëlqim 07” SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në këtë procedurë prokurimi si më poshtë vijon:*

1. BOE “KMK” SHPK & “Caushi M” SHPK	34,986,000	I kualifikuar
2. “Shendelli” SHPK	43,858,875	I kualifikuar
3. “Shkëlqim 07” SHPK	47,000,000	I kualifikuar
4. BOE “Ndregjoni” SHPK & “Udha” SHPK	28,061,425	I skualifikuar
5. “LTE Construction” SHPK	35,087,500	I skualifikuar
6. “B93 II” SHPK	40,000,570	I skualifikuar
7. “VAS Konstruksion” SHPK	55,554,650	I skualifikuar

*Në datën 24.05.2021 kemi paraqitur ankesën tonë si më poshtë:*

*Në referim dhe zbatim të nenit 56 të LPP dhe VKM si dhe dokumentave standarde të procedurës së hapur-punë me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Bejar-diga e rezervuarit” apo dhe nenit 93 të ligjit nr. 162/2020, rezultojn se oferta e renditur në vendin e parë është anormalisht e ulët.*

### **3.4 Ofertat anormalisht të ulëta**

3.4.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me punët e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.4.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përlogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

$O$  – Oferta

$M_O$  – Mesatarja e Ofertave të vlefshme

$n$  – Numri i Ofertave të vlefshme

$Z_M$  – Zbritja e Mundshme

$M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / n$

$Z_M = 85 \% M_O$

Vlera e Ofertës që vlerësohet  $<..Z_M.....$  , si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

Nga zbatimi i referencës së mësipërme rezulton se:

1. BOE "KMK" SHPK & "Caushi M" SHPK	34,986,000
2. "Shendelli" SHPK	43,858,875
3. "Shkëlqim 07" SHPK	47,000,000

$M_O$  - Mesataria e ofertave të vlefshme = 41,948,292

$Z_M$  – Zbritja e mundshme = 35,656,048

*Nga 3 (tre) oferta të rezultuara të rregullta dhe të kualifikuara për në garën ekonomike, oferta e subjektit i renditur i pari me vlerë 34,986,000 rezulton të jetë anomalisht e ulët. Në kushtet kur kërkojmë rivlerësim të vendimarrjes së KVO-së, kërkojmë të diskutohen, rivlerësohen çështjet e mëposhtme:*

1. *A ka ndjekur AK-KVO procedurën ligjore në këtë rast?*
2. *Nëse e ka ndjekur, a ka operatori ekonomik përkatës me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune nga kërkesa e AK, shpjegime për elemente të veçanta të ofertës për:*
  - a) *anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
  - b) *zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
  - c) *origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
  - ç) *zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*
3. *A ka verifikuar informacionin e operatorit ofertues autoriteti kontraktor?*
4. *Nëse janë paraqitur analizat e kosto çmimesh. A janë punuar mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015, VKM nr. 1025, datë 16.12.2020?*
5. *Konsiderohen oferta të pranueshme ato oferta, të cilat: b) janë anomalisht të ulëta dhe të paargumentuara; Nëse e ka verifikuar dhe është bindur nga informacioni i paraqitur, cilat janë arsyet bindëse të pranimit dhe mosrefuzimit të ofertës së subjektit të renditur i pari si një ofertë jo seriozë dhe anomalisht e ulët dhe e paargumentuar?*  
*Sa më sipër, kemi kërkuar prej autoritetit kontraktor, rivlerësim, transparencë në procedurën e prokurimit, mosdiskriminim dhe trajtim të barabartë të ofertuesve. barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngrakohen ofertuesve të prokurimit publik. Kemi kërkuar rivlerësim dhe për një arsye tjetër siç është mendimi se kemi të bëjmë me “diskriminim pozitiv” mbi subjektet ofertuese “KMK” SHPK & “Shendelli” SHPK si ofertues që nuk duhet të kualifikoheshin.*

*-Nuk duhet të kualifikoheshin pasi nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit të vendosura nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër në dokumentat e tenderit të procedurës së hapur-punë me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Bejar-diga e rezervuarit” për kapacitetin teknik të kërkuar si më poshtë:*

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Mjeteve/Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 18 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 10</i>
<i>2</i>	<i>Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1 – 2.5 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
<i>3</i>	<i>Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3 - 4 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
<i>4</i>	<i>Kamion me vinç</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>5</i>	<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
<i>6</i>	<i>Eskavator me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>7</i>	<i>Buldozer</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>

8	Minisekavator	në pronësi ose me qira	Copë 4
9	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
10	Autopompë betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Rrul gomë-gomë për asfalt, mbi 14 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Rrul hekur-hekur mbi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
13	Rrul vibrues gomë – hekur mbi 18 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Rrul me kompresor dhe vibrim minimumi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 2
17	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 2
18	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Pajisje topografike	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Nivelues lazer	në pronësi ose me qira	Copë 2
21	Frezë për frezim rruge	në pronësi ose me qira	Copë 2
22	Batipal	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Vibrator	në pronësi ose me qira	Copë 3
24	Motobetonierë kapacitet min. 0.5 m <sup>3</sup>	në pronësi ose me qira	Copë 2
25	Fikse zjarri	në pronësi ose me qira	Copë 5
26	Kuti të ndihmës së shpejtë	në pronësi ose me qira	Copë 5
27	Gjenerator të paktën 50 kw	në pronësi ose me qira	Copë 1
28	Semaforë sinjalistike për punime rrugore	në pronësi ose me qira	Copë 1
29	Tabela sinjalistike sigurimi teknik	në pronësi ose me qira	Copë 50
30	Prozhektorë ndriçimi	në pronësi ose me qira	Copë 5
31	Rimorkiator – tërheqës	në pronësi ose me qira	Copë 2
32	Rimorkio për transport makinerie	në pronësi ose me qira	Copë 2

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit: -lej qarkullimi; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -certifikata e transportit të lëshuar nga organet kompetente dhe fotot përkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit; Ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë e vlefshme.
- Për mjetet e transportit të mallrave të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi si të rrezikshme (autobitumatriçe) duhet të paraqitet certifikata për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar.

Rezulton se nga verifikimi në website të Q.K.B.-së, operatori “KMK” SHPK nuk disponon licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Kodi III.2.B “Transportimi i mbetjeve jo të rrezikshme nga ndërtimet dhe prishjet”. Sa më sipër ky operator duhej skualifikuar. Duhej skualifikuar se nuk plotëson kriterin e ëvënë nga vet autoriteti kontraktor.

- Rezulton se operatori “Shendelli” SHPK është shpallur fitues nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallkastër, nr.REF-88821-03-02-2021. Përshkrim i shkurtër i kontratës:

*“Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtjen rrugë në fshatra, për nevoja të NSHP”, me afat kontrate 3 muaj. (Buletini Nr.70, datë 10.05.2021). Normalist ngrihet pyetja: A janë mjetet e paraqitura nga ky operator të njëjta me ato në procedurën ku Bashkia Mallakastër e ka shpallur fitues?*

*Pasi ne jemi në dijeni se ky operator nuk disponon minimalisht 10 (dhjetë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton. Aq më tepër në kushtet kur kemi të bëjmë me periudhë të njëjtë zbatimi kontratash (të paktën 3 muaj). Sa më sipër, mendojmë se ky operator duhej skualifikuar. Duhej skualifikuar se nuk plotëson kriterin e vënë nga vet autoriteti kontraktor.*

*Për autoritetin kontraktor llogjikisht ngrihen pyetjet si më poshtë:*

- Ku qëndron interesi i autoritetit kontraktor dhe qëllimi i përzgjedhjes, oferta më e mirë ekonomike-teknike apo oferta më e keqe? Ne besojmë se është në përzgjedhjen e një oferte më të mirë ekonomike-teknike.*
- A ka lapsuse (diskriminim pozitiv) për ofertat e tjera? Për shembull, nuk plotësojnë kriteret e vendosura dhe pa dashje (lapsus) janë konsideruar të plotësuar? Rrjedhimisht kualifikohen ofertues që nuk duhet të kualifikoheshin.*

*Sa më sipër, është mëse e qartë se, kemi të bëjmë me vlerësim dhe kualifikime të gabuara nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave. Vlerësimi i gabuar ka bërë që ti mohohet qenia fitues e kompanisë së ndërtimit “Shkëlqimi 07” SHPK në këtë procedurë, në të cilën është oferta fituese. Autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale kapacitetet e dokumentuara nga ofertuesit në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilat vendosen kriteret e përcaktuara. Përfundimisht, me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor Bashkia Mallakastër kemi kërkuar: pezullimin e procedurës, rivlerësimin, skualifikim të operatorëve që janë kualifikuar padrejtësisht dhe që nuk plotësojnë kriteret e vendosura për kualifikim, dhe rrjedhimisht shpalljen fitues të shoqërisë së ndërtimit “Shkëlqimi 07” SHPK për objektin “Rikonstrukcion i rrugës Bejar – diga e rezervuarit”, me nr. REF-91657-03-30-2021.*

II.5. Me vendimin nr. 1293/2 prot., datë 26.05.2021 autoriteti kontraktor ka vendosur vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.6. Në datën 02.06.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1424/1 prot., datë 10.06.2021 protokolluar me tonën me nr. 970/2 prot ., datë 14.06.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

### Arsyeton

III.1 Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shkëlqimi 07” SHPK për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK me arsyetimin se:

- Rezulton se operatori “Shendelli” SHPK është shpallur fitues nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër, nr.REF-88821-03-02-2021. Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtjen rrugë në fshatra, për nevoja të NSHP”, me afat kontrate 3 muaj. (Buletini Nr.70, datë 10.05.2021). Normalisht ngrihet pyetja: A janë mjetet e paraqitura nga ky operator të njëjta me ato në procedurën ku Bashkia Mallakastër e ka shpallur fitues?

Pasi ne jemi në dijeni se ky operator nuk disponon minimalisht 10 (dhjetë) kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) ton. Aq më tepër në kushtet kur kemi të bëjmë me periudhë të njëjtë zbatimi kontratash (të paktën 3 muaj). Sa më sipër, mendojmë se ky operator duhej skualifikuar. Duhej skualifikuar se nuk plotëson kriterin e vënë nga vet autoriteti kontraktor.

Për autoritetin kontraktor llogjikisht ngrihen pyetjet si më poshtë:

- Ku qëndron interesi i autoritetit kontraktor dhe qëllimi i përzgjedhjes, oferta më e mirë ekonomike-teknike apo oferta më e keqe? Ne besojmë se është në përzgjedhjen e një oferte më të mirë ekonomike-teknike.
- A ka lapsuse (diskriminim pozitiv) për ofertat e tjera? Për shembull, nuk plotësojnë kriteret e vendosura dhe pa dashje (lapsus) janë konsideruar të plotësuar? Rrjedhimisht kualifikohen ofertues që nuk duhet të kualifikoheshin, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1 Në shtojcën 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.9, “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e punimeve objekt kontrate. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik (shtojca 10), si më poshtë:

Nr	Lloji i Mjeteve/Makinerive	Statusi	Sasia
1	<b>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 18 ton</b>	<b>në pronësi ose me qira</b>	<b>Copë 10</b>
2	Kamioncinë me kapacitet mbajtës 1 – 2.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamioncinë me kapacitet mbajtës 3 - 4 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2



4	<i>Kamion me vinç</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
5	<i>Eskavatorë me zinxhira</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
6	<i>Eskavator me goma</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
7	<i>Buldozer</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
8	<i>Minisekavator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 4</i>
9	<i>Autobetoniere</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
10	<i>Autopompë betoni</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
11	<i>Rrul gomë-gomë për asfalt, mbi 14 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
12	<i>Rrul hekur-hekur mbi 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
13	<i>Rrul vibrues gomë – hekur mbi 18 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
14	<i>Rrul me kompresor dhe vibrim minimumi 10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
15	<i>Autobitumatriçe</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
16	<i>Grejder</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
17	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
18	<i>Autobot uji</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
19	<i>Pajisje topografike</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
20	<i>Nivelues lazer</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
21	<i>Frezë për frezim rruge</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
22	<i>Batipal</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
23	<i>Vibrator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 3</i>
24	<i>Motobetoniere kapacitet min. 0.5 m<sup>3</sup></i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
25	<i>Fikse zjarri</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 5</i>
26	<i>Kuti të ndihmës së shpejtë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 5</i>
27	<i>Gjenerator të paktën 50 kë</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
28	<i>Semaforë sinjalistike për punime rrugore</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
29	<i>Tabela sinjalistike sigurimi teknik</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 50</i>
30	<i>Prozhektorë ndriçimi</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 5</i>
31	<i>Rimorkiator – tërheqës</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>
32	<i>Rimorkio për transport makinerie</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 2</i>

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit: -leje qarkullimi; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -certifikata e transportit të lëshuar nga organet kompetente dhe fotot përkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit; Ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qerasë e vlefshme.
- Për pajisjet dhe mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata apo fatura e blerjes apo deklarata doganore, ndërsa për pajisje/mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e qerasë.
- Për mjetet e transportit të mallrave të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi si të rrezikshme (autobitumatriçe) duhet të paraqitet certifikata për transport mallrash të rrezikshme, lëshuar nga institucioni kompetent i autorizuar.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë vendodhjen e saktë të mjeteve të deklaruara me qëllim verifikimi në çdo kohë nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës disponueshmërinë e mjeteve e pajisjeve teknike të deklaruara sipas shtojcës nr.10. (Deklaratë nga përfaqësuesi i shoqërisë ofertuese).
- Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se të gjitha mjetet e pajisjet e deklaruara do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

III.1.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Shendelli” SHPK, në përmbushje të kriterit, konkretisht për **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 18 ton** sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1-Kontratë qiraje me nr. 1414 rep., nr. 515 kol., datë 29.04.2021, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Loti” SHPK, për kamion me targa AA529PP, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton.

2-Kontratë qiraje me nr. 1871 rep., nr. 811 kol., datë 18.12.2020, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Zeon” SHPK, për gjysëm rimorkion me targa ACR416 dhe koka tërheqëse me targa AA378GF, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton.

3-Kontratë qiraje me nr. 1407 rep., nr. 510 kol., datë 29.04.2021, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Alba Konstruksion” SHPK, për kamion me targa AA834KJ, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton.

4-Kontratë qiraje me nr. 1407 rep., nr. 510 kol., datë 29.04.2021, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Alba Konstruksion” SHPK, për gjysëm rimorkion me targa AGR991 dhe koka tërheqëse me targa AB456AF, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton, -leje qarkullimi; -certifikata e kontrollit teknik; -polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); -certifikata e transportit të lëshuar nga Bashkia Vorë dhe foto përkatëse ku është e dukshme targa e mjetit.

5-Kontratë qiraje me nr. 1871 rep., nr. 811 kol., datë 18.12.2020, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Zeon” SHPK, për gjysëm rimorkion me targa ADR082 dhe koka tërheqëse me targa AA739KP, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton.

6-Kontratë qiraje me nr. 1408 rep., nr. 511 kol., datë 29.04.2021, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Ed Konstruksion” SHPK, për kamion me targa AA149PF, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton.

7-Kontratë qiraje me nr. 1414 rep., nr. 515 kol., datë 29.04.2021, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Loti” SHPK, për kamion me targa AA175GC, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton.

8-Kontratë qiraje me nr. 1411 rep., nr. 514 kol., datë 29.04.2021, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Egland” SHPK, për gjysëm rimorkion me targa AFR254 dhe koka tërheqëse me targa AA206MU, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton.

9-Kontratë qiraje me nr. 1871 rep., nr. 811 kol., datë 18.12.2020, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Zeon” SHPK, për gjysëm rimorkion me targa AAR649 dhe koka tërheqëse me targa AA530DE, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton.

10- Kontratë qiraje me nr. 1410 rep., nr. 513 kol., datë 29.04.2021, ndërmjet shoqërisë “Shendelli” SHPK dhe shoqërisë “Totila” SHPK, për gjysëm rimorkion me targa AFR487 dhe koka tërheqëse me targa AA057XP, me kapacitet mbajtës mbi 18 ton.

III.1.3 Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*

III.1.4. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik Të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala*

*“periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit”.*

III.1.5. Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e depozitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, sqaron se: *“Për përmbushjen e kësaj kërkesë nga operatori ekonomik “Shëndelli” SHPK, është paraqitur shtojca nr.10, e plotësuar me mjetet dhe makineritë e propozuara për realizimin e objektit të kontratës, si dhe dokumentacioni shoqëruar për këto mjete dhe makineri. Gjithashtu, është paraqitur edhe deklara përkatëse nëpërmjet së cilës operatori ekonomik “Shëndelli” SHPK deklaroi se: “Mjetet/makineritë e mësipërme të punës që janë kërkuar dhe që janë deklaruar për këtë objekt prokurimi do të jenë të angazhuara deri në përfundim të këtij objekti në kohë dhe nuk do të anagazhohen në kontrata të tjera, gjithashtu nuk janë të deklaruara në procedurat të tjera shpallura fituese nga autoriteti kontraktor”.*

*Nga verifikimet e kryera nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, rezultoi se disa nga mjetet e propozuara për realizimin e objektit “Rikonstruksioni i rrugës Bejar-diga e rezervuarit”, janë deklaruar gjithashtu edhe për realizimin e procedurës me objekt “Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtje rruge në fshatra, për nevoja të NSHP”, procedurë e cila është zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër dhe në të cilën operatori ekonomik “Shëndelli” SHPK është shpallur fitues.*

*Në plotësimin e kësaj kërkesë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se thelbi dhe synimi i saj është disponimi nga ana e operatorit ekonomik i mjeteve dhe makinerive të kërkuara, ndërsa angazhimi efektiv i tyre për realizimin e punimeve objekt kontrate, mund të bëhet me alternim në orare të ndryshme në kantiere të ndryshme, gjë e cila nuk çënon zbatimin e kontratës, për vetë faktin se të dy kantieret e ndërtimit, janë brenda juridiksionit territorial të Bashkisë Mallakastër dhe kanë një distancë të vogël ndërmjet tyre”.*

III.1.6. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret kualifikuese të

përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Operatori ekonomik "Shendelli" SHPK, ka paraqitur dokumentacionin e duhur në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, sipas së cilës janë paraqitur numri i mjeteve të kërkuara, konkretisht 10 copë për "kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 18 ton". Për sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, është në kushtet kur operatori ekonomik "Shendelli" SHPK konsiderohet se përmbushin kriterin e përcaktuar nga autoritetit kontraktor për "kamion vetëshkarkues me kapacitet mbi 18 ton", në dokumentet e tenderit.

III.1.7. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik "Shendelli" SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë për kontratat e lidhura apo në proces, ku asnjëra prej tyre nuk rezulton të jetë kontratë e lidhur me Bashkinë Mallakastër;

-Deklaratë e operatorit ekonomik "Shendelli" SHPK, në të cilën deklarohet se: "Mjetet/makineritë e mësipërme të punës që janë kërkuar dhe që janë deklaruar për këtë objekt prokurimi do të jenë të angazhuara deri në përfundim të këtij objekti në kohë dhe nuk do të angazhohen në kontrata të tjera, gjithashtu nuk janë të deklaruara në procedurat të tjera shpallura fituese nga autoriteti kontraktor .

-Makineritë e deklaruara sipas Shtojcës 10 të deklaruara për këtë objekt prokurimi ndodhen në sheshin e ndërtimit të shoqërisë në rrugën Fier Hamil km 4. Autorizohet autoriteti kontraktor të bëjë verifikimin e mjeteve në çdo kohë dhe pa paralajmërin, mjetet dhe pajisjet vendndodhja e të cilatve është në sheshin e ndërtimit të shoqërisë.

- Deklaratë e operatorit ekonomik "Shendelli" SHPK, datë 30.04.2021, në të cilën deklarohet se: "Makineritë e deklaruara sipas Shtojcës 10 janë të disponueshme gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës".

III.1.8. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...*"

III.1.9. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet

shprehimisht se:

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- e) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- f) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik Të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- g) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- h) Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit”.*

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar (deklaratat për mjetet), në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) të operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimimi ka paraqitur dokumentacionin e duhur në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, sipas së cilës është paraqitur deklarata përkatëse nga operatori ekonomik, nëpërmjet të cilës, deklaroi se, makineritë, sipas kërkesave të tenderit nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera për të gjithë periudhën e përcaktuar në dokumentat e tenderit si afati i kryerjes së shërbimit si dhe vendndodhjen e tyre me qëllim verifikimi në çdo kohë nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, thjesht e vetëm fakti i evidentuar nga autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues, se operatori ekonomik “Shendelli” SHPK është shpallur fitues dhe është kualifikuar duke u renditur i pari edhe në një procedurë tjetër me objekt “Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtje rruge në fshatra, për nevoja të NSHP”, nuk mund të shpallë deklaraten e administratorit të shoqërisë përkatëse “Shendelli” SHPK, për angazhimin e mjeteve të deklaruara në rast se shpallet fitues për procedurën në fjalë, e aq më pak, të shërbejë automatikisht si shkak skualifikimi. Për më tepër, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar që operatorët ekonomikë të deklarojnë që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera, në këtë rast autoriteti kontraktor nuk mund të vlerësojë një ofertues për një kriter të pa kërkuar në kundërshtim edhe me nenin 55/2 të LPP i cili parashikon se: “2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”.

Ndërkohë që, vetë autoriteti kontraktor ka evidentuar në shkresën nr. 1293/2 prot., datë 26.05.2021 “Shqyrtim ankese” drejtuar operatorit ekonomik ankimuesit, se disponon një kontratë të lidhur me operatorin ekonomik Shendelli” SHPK për procedurën me objekt “Blerje materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtje rruge në fshatra, për nevoja të

NSHP”, por nuk ka dhënë asnjë informacionin të nevojshëm mbi përqindjen e realizimit të kësaj kontrate dhe se kur është lidhur kjo kontratë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Sa më sipër analizuar, konstatojmë se, jemi përpara rastit klasik kur nga ana e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit në lidhje me angazhimin e mjeteve vetëm në këtë kontratë dhe autoriteti kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Shkëlqimi 07” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Shkëlqimi 07” SHPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimit të operatorëve ekonomikë “KMK” SHPK & “Caushi M” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt shyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Shendelli” SHPK përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të Komisionit do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “KMK” SHPK & “Caushi M” SHPK, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19 njëzëri

**Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shkëlqim 07” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-91657-03-30-2021, me objekt “*Rikonstruksion i rrugës Bejar – diga e rezervuarit*”, me fond limit 59,394,361.54 (pesëdhjetë e nëntëmilion e treqind e nëntëdhjetë e katërmijë e treqind e gjashtëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa T.V.SH, zhvilluar në datën 30.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Mallakastër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 970 Protokoli, Datë 02.06.2021**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Fiorent Zguro</b>	<b>Anila Malaj</b>	<b>Kreshnik Ternova</b>
	<b>Kryetar</b>	
	<b>Jonaid Myzyri</b>	